



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5810 prot.

Tiranë, më 09. 9 .2022

URDHËR

Nr. 516, datë 09. 9 .2022

PËR

**PËRFSHIRJEN NË KATALOG TË TEKSTIT SHKOLLOR TË VETËM
TË PËRBASHKËT “ABETARE”, KLASA E PARË, NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR, PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, të nenit 47 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 724, datë 24.11.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përjashtimin nga procedura e përzgjedhjes nga mësuesit në bazë shkolle të tekstit të abetares”,

URDHËROJ:

1. Përfshirjen e tekstit shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”, klasa e parë, në sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023, në katalogun bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSE



SHTESE KATALOGU, KLASA 1, VITI SHKOLLOR 2022-2023

Klasa & Titulli	Botuesi/Distributori	Autori / Autorët	Çmimi i shitjes me pakicë për nxënësin (jo më i lartë, pa TVSh) për V.2019-2020	Çmimi i shitjes me pakicë për nxënësin (jo më i lartë, pa TVSh) për V.2020-2021	Çmimi i shitjes me pakicë për nxënësin (jo më i lartë, pa TVSh) për V.2021-2022	Çmimi i shitjes me pakicë për nxënësin (jo më i lartë, pa TVSh) për V.2022-2023
1	2	4	5	6	7	7
Klasa 1						
Abetare	Botime Pegi & Dukagjini	Mimoza Gjokutaj Nasel Zabeli	517	528	537	548
		Saranda Kumnova Pozhegu Tereza Babasuli				
Abetare Pune	Botime Pegi & Dukagjini	Mimoza Gjokutaj Nasel Zabeli	248	253	258	263
		Saranda Kumnova Pozhegu Tereza Babasuli				

Shënim:

Referuar ligjit nr. 96/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 28.12.2018, në fuqi nga data 01 janar 2019), furnizimi (shitja) e librave është furnizim i tatueshëm me shkallë të reduktuar të TVSh-së prej 6 (gjashtë) përqind. Të gjithë operatorët janë të detyruar të respektojnë legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

